



Titulli i projektit

“Dita e Verës” (Wine Day)

Tipi i projektit

Aktivitete/ Evente kulturore-turistike

Vendndodhja e projektit

Lezhë, Kallmet, Blinisht, Dajç, Hajmel, Bushat dhe Vau Dejës.

Buxheti i paravlerësuar

15 000 Euro /vit

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve


Kallmeti dhe Zadrime shquhen për prodhimet bujqësore. Ato janë të favorizuara edhe nga pozita gjeografike, relievi kodrinor dhe fushor, si prania në këtë territor e Lumit Drin. Një nga prodhimet bujqësore për të cilat shquhen Kallmeti dhe Zadrime, është varieteti autokton i rrushit, produkt kryesor i të cilit është vera. Prodhimi i verës në mënyrë artizanale është lënë disi pas dore. Kjo vjen si shkak i ndërtimit të disa kantina të verës në zonë, por edhe për arsye të emigrimit të krahut të punës. Gjatë viteve 2007-2013, në sajë të subvencioneve në bujqësi nga qeveria, por edhe kthimit të shumë emigranteve, ka filluar mbjellja e vreshtave në zonën e Kallmetit dhe Zadrimes, duke rikthyer traditën e kultivimit të varieteteve autoktone të rrushit dhe prodhimit të verës. Rikthimi i kësaj tradite, por edhe të vetëpunësimi i banorëve, sjell nevojën e promovimit të këtyre produkteve dhe nxitjes së fermerëve të tjerë në kultivimin e produkteve autoktone të rrushit dhe prodhimit të verës, si një mënyrë e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të zonës.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti kryesor i projekti është nxitja fermerëve të zonës në kultivimin e varieteteve autoktone të rrushit dhe prodhimit të verës, si dhe promovimi i produkteve të tyre, si një mënyrë e qëndrueshme e zhvillimit të zonës.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Nga realizimi i këtij projekti përfitojnë fermerët e 3 njësisve të zonës së Lezhës dhe 3 të Bashkisë Vau i Dejës. Përfitues direktë të projektit janë 7 kantinat e këtyre njësisve, si dhe 50 fermerë që merren me prodhimin e verës në mënyrë tradicionale. Fermerët do të ndihmohen me fletëpalosje informative rreth prodhimit të verës në menyre tradicionale, në krijimin e lidhjeve me kantinat e verës, në mënyrë që të sigurohet një treg për produktet bujqësore të tyre, si dhe promovimin e produkteve të tyre në panairin e “Dites së Verës”. Zhvillimi i këtij projekti do të ndikojë direkt në përfitimet e fermerëve pjesëmarrës në aktivitet, si dhe në krijimin e një aktiviteti të përvitshëm, pjesë e kalendarit të aktiviteve të Bashkisë Lezhë.



Aktivitetet e projektit

- Hartimi i fletëpalosjeve me informacione rreth varieteteve të rrushit dhe verërave autoktone të Kallmetit dhe Zadrimës (çilesitë, harta shtrirjes së vreshtave, sasia e vreshtave, vizioni për 10 vitet e ardhshme, mënyra artizanale e prodhimit të verës dhe kapacitet e prodhimit të kantinave ekzistuese.)
- Dita e Verës (gdo shtator)
- Prezantim i varieteteve autoktone të rrushit dhe verës nga vajzat me veshje tradicionale të zonës.
- Prodhimi i verës në menyrë tradicionale (duke u shtypur me këmbë) nga të rinjtë me veshje tradicionale të zonës.
- Panair i prodhimeve të rrushit.
- Konkurs i produkteve të verës nga juri profesioniste somelierësh dhe përfaqesues të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.
- Ceremoni e ndarjes së çmimeve
- Koncert me grupet artistike të zonës.
- Buffet (prodhime tradicionale të zones).
- I gjithë aktiviteti do të shoqërohet me muzikë live.

Maturimi i projektit

Koncepti për projektin është i gatshëm dhe planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve është i lehtë. Kjo vjen si rrjedhojë e përvojave të ngjashme të Komunës Kallmet dhe njërive të tjera pjesëmarrëse. Ky projekt lidhet edhe me projektet e tjera në sektorin e bujqësisë të parashikuara për ZF Lezhë.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financues potencialë të projektit janë Bashkia dhe donatorët. Bashkia do të ketë autorësinë e projektit. Ky do të jetë i parashikuar dhe i miratuar në PBA-në e bashkisë, si një mënyrë për të siguruar qëndrueshmërinë e tij edhe për vitet në vazhdim. Gjithashtu do të synohet edhe sigurimi i mbështetjes nga subjekte ekonomike të fushës, siç janë kantinat e verës, si përfitues të drejtpërdrejt të projektit.

Kostot e projektit

- Identifikimi i fermerëve dhe kantinave të verës pjesëmarrës në aktivitet: 2000 Euro
- Hartimi dhe printimi i 500 brushurave informuese: 1000 Euro
- Panairi i "Ditës së Verës" (transport+tavolina+tenda, etj.): 5000 Euro
- Çmimet e Konkursit të Verës: 1000 Euro
- Koncerti dhe grupet artistike: 2000 Euro
- Buffet: 1000 Euro
- Media + Banderola + Njoftimet: 1500 Euro
- Kosto personeli: 1500 Euro